



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDrySHE**

2 mars 2016, Prizren

**REAGIM  
Ofendimet nuk janë shërbime publike**

EC Ma Ndryshe reagon ndaj gjuhës ofenduese që Drejtori i Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit, Hasan Hasani ka përdorë të martën në komunikimin me monitoruesit e organizatës sonë, pak para fillimit të takimit të rregullt të Kryetarit të Komunës me drejtorët e Ekzekutivit lokal.

Drejtori Hasani një pakënaqësi të tij, në lidhje me aktivitetet e organizatës, që lidhen ngushtë me interesin publik, e ka shprehur në bisedë me monitoruesin duke përdorë shprehje ofenduese, që nuk duhet të jenë pjesë e fjalorit të një zyrtari të lartë publik, e aq më pak të drejtuesit të dikasterit që angazhim kryesor ka shërbimet publike.

EC Ma Ndryshe përkujton se ky nuk është rasti i parë që ky zyrtar i lartë publik komunikon në këtë mënyrë me bashkëbiseduesit e tij. Përmes këtij reagimi EC Ma Ndryshe ia bën me dije drejtorit Hasani se ofendimet nuk janë shërbime publike. Prandaj, në vend të përdorimit të shprehjeve të ulëta ai duhet të koncentrohet në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

Në të njëjtën kohë nënvizojmë se posti publik nuk është pronë as posedim i tij personal, prandaj dhe duhet të sillet konform përgjegjësi që ka marrë për t'i shërbyer publikut, dhe jo tekeve apo nervozës së tij personale.

Fyerjet dhe ofendimet në adresë të cilësdo palë nuk guxojnë të jenë pjesë e diskursit të zyrtarëve publik. Prandaj EC Ma Ndryshe shpreh indignatën për këtë kulturë të shprehjes dhe kërkon nga drejtuesit e Komunës që ta kenë parasysh se sjelljet e tilla nuk përkojnë me standardet e qeverisjes së mirë dhe në interes të publikut.

Pavarësisht nga ky incident, EC Ma Ndryshe thekson se nuk do të zbrapset nga angazhimi i deritanishëm civil për një ambient më të mirë jetësor për të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Me respekt,  
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr.5 - Prizren  
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr.5, Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

**OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)**  
Rr. Saraçët 5, Prizren ~ Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr.5, Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) ~ [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) ~ 038-224-967 & 029-222-771